

REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -V- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 MAJ 2021

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Agim Krasniqi, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxfalio, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Fitim Halili, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-pasi përshëndeti të pranishmit, ngrit shqetësimin e tij për siç vlerësoi punësimet pa kritere dhe mbi baza politike që po ndodhin në Komunën e Vushtrrisë e që janë pa dyshim të dëmshme. Për këtë ilustruj me rastin më të freskët siç është rasti i punësimit të asistentes të kryetarit të komunës në QKMF në Vushtri, ku me këtë rast është shuar vendi i punës së një mjeku, duke u bërë dy jurist që janë të punësuar e që vetëm njëri do mund ti kryente punët në atë fushë. Pastaj rasti tjetër i punësimit nepotist është ai motrës së gruas të kryetari të komunës. Kjo përpos që është e dëmshme, bënë që hapja e konkurseve bëhet sa për sy e faqe, dhe për të luajtur me ndjenjat e qytetarëve sepse punësimet bëhen nga xhepat e kryetarit të komunës, shumë më mirë dhe më e ndershme do të ishte të mos shpallej fare konkurs që të mos mashtrohen qytetarët të cilët i gëzohen atyre konkurseve, pas që ata dihen se të punësuarit janë të emëruar nga vet kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri. Kjo për më tepër është fyerje e inteligjencës të atyre qytetarëve që janë të përgatitur për ato vend pune, e meritojnë dhe në fund dëshpërohen me vetveten, duke u kthyer në shtëpi e duke i thënë vetës se ndoshta unë nuk kesh i aftë për atë vend pune. Këto veprime që po ndodhin në Komunën e Vushtrris vërtet janë të ulëta dhe ato po udhëhiqen nga kryetari i komunës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ka muaj prej kur kemi diskutuar një çështje për të cilën kryetarit aktual, çdo zë që nuk i përshtatej, ishte i padëgjueshëm, madje edhe zëri i organeve që kanë autoritet mbi komunat. Është fjala për objektin e ish- Gjykatës në Vushtri, çështje për të cilën uroj të mos flas më në këtë kuvend. Këtë fjalim, nuk po e mbaj për kryetarin të cilit nuk i hyri në vesh asnjë fjalë e asnjë kërkesë por po e mbaj për t'i informuar qytetarët mbi të vërtetat që kanë ndodhur sa i përket këtij objekti. Për të mos u dukur që gjithë kjo luftë po bëhet veç pse jemi opozitë, dua të sqaroj për qytetarët që propozim-vendimin për rrënim e kam kundërshtuar edhe në tetor të vitit 2020, ku aso kohe ishim në koalicion me LDK, më është dukur e dyshimtë, mos zhvillimi i procedurave të vendimit që ky kuvend e ka marr për këtë pronë në vitin 2019, shpallja e interesit etj dhe akoma më e dyshimtë e gjithë çështja e këtij objekti, kur e kam parë insistimin e kryetarit për t'u bërë ajo që e ka propozuar e duke e sjell në kuvend me arsytetime të ndryshme, derisa e kaloi si vendim duke u bërë bashkë me PDK-në. Kryetari i cili na qenka shumë ihtar i madh i hapësirave publike, është po i njëjti që nuk i bëhet vonë që e ka paralizuar rrugën më të frekuentuar të prindërve me fëmijë të vegjël duke lejuar të bllokohen trotuarët nga terrasat, e është po i njëjti kryetar që përderisa aludon për pasigurinë e këtij objekti të ndërtimit masiv të vitit 1964 nuk merret fare me ndërtesën kolektive të vitit 1925 që është në rrugën "Dëshmorët e Kombit" e cila është buzë shkatërrimit dhe e cila edhe i rrezikon jetën banoreve aty e edhe mundet ti le pa kulm mbi koke 19 familje. Kryetari ka bërë shkelje ligjore kur vendimin për rrënim, nuk e ka sjell për rishqyrtim sipas instruksioneve të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, e shkelje akoma më të madhe ka bërë kur përkundër kërkesës së Ministrisë së Kulturës edhe përmes emailit zyrtar e edhe ftesës publike, ka urdhëruar që rrënimi të bëhet në një ditë të Diele, në orën 7 të mëngjesit, pa asnjë kusht të plotësuar për rrënim. E ky fat i ka gjetur edhe shumë objekte tjera, të cilat kanë qene pengesë e projekteve biznese. Matematikat e kryetarit se e diela e mëngjesit i zë të gjithë fjetur nuk doli, atë ditë arritëm që me kohë ta ndalim atë veprim kundërligjor duke u ndihmuar nga organet e policisë të cilët i falënderoj publikisht për punën dhe durimin. Mendimi im personal nuk ka qene asnjëherë kategorik kundër rrënit, por gjithmonë jam thirrur në atë se duhet ti zhvillojmë procedurat sipas vendimeve të marra paraprakisht, e duke u thirrur në atë se vendimet e tilla duhet të decentralizohen duke u marrë mendime edhe nga qytetarët nëpër diskutime publike, e duke bashkëpunuar edhe me nivelin qendror. Unë, bashkë me shoqërinë civile jemi munduar që të ndalojmë çdo veprim antiligjor të kryetarit për këtë çështje, por tani mbesim me shpresën se ministrinë e involvuara do të angazhohen që gjithçka të shkoj sipas ligjit e kushdo që ka vepruar kundër ligjit të marr dënimin e merituar.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-adresi shqetësimin e banorëve të fshatit Studime e Poshtme, të cilët kanë organizuar protesta për rrugën magjistrale që lidhet me rrugën e fshatit Studime, ku janë të vendosur semaforët, thelbi i kësaj problematike është shpronësimi i një parcele tokësore, që është adresuar disa herë nëpër gjykata. Kjo rrugë po i rrezikon banoret e atij lokaliteti dhe lokaliteteve tjera përreth, andaj kërkoi që ky problem të adresohet dhe të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se pas themelimit të organeve komunale në dhjetorin e vitit 2017, kryetari i komunës në atë kohe kishte adresuar kërkesë, që anëtarin e kuvendit z. Milian Bojkovic nga radhët e listës serbe, ta zgjedhin zëvendës/kryesues për komunitete në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë. Një kërkesë e tillë ishte kundërshtuar nga LVV-ja në Vushtri me arsyen e bazuar se një komunitet pakicë duhet të jetë mbi 10% e popullsisë së atij qyteti për ti takuar pozita në fjalë. Kjo ishte bërë edhe për faktin se lista serbe nuk e njehe Republikën e Kosovës. Pas një debati të gjatë dhe kundërshtimit të tyre të fuqishëm, kryetari i komunës është zbrapsur nga kërkesa e tij që përfaqësuesi serb të jetë zëvendës/kryesues i kuvendit, por bashkëpunimi i kryetarit

të komunës me këtë asamblist ka vazhduar gjë e cila dëshmohet me votimin e të gjitha pikave të sjella në kuvend nga kryetari i komunës. Andaj kryetari i komunës ka përgjegjësi para kuvendit dhe para qytetarëve që të përgjigjet se cilat janë lidhjet e tij me partin politike Lista Serbe, sepse tashmë po shihet qartë se ky koalicion ekziston dhe kjo përsërit se po vërtetohet me anët të votimit të këtij asamblisti të propozim-vendimeve që ofron në kuvend nga ana e kryetarit të komunës.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-paraqiti një pikë shtesë për futej në rend të ditës që lidhet me rishqyrtimin e vendimit të kuvendit të komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për KEDS-in. Ndryshimi i këtij vendimi lidhet me dhënien e pronës në shfrytëzim me kompensim vjetor prej 600 € në vit në ZK-Gojbulë.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-përkrahu idenë që futet në rend të ditës diskutimi për rrugën “2 maj” që kjo çështje të sensibilizohet edhe në ministrinë që është kompetentet për ta vendosur këtë çështje.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-duke ju referua diskutimeve për gjendjen e rrugës “2 maj” adresoi shqetësimin e tij për gjendjen e keqe që ekziston në atë rrugë, ku qytetaret atje rrezikohen çdo ditë qoftë këmbësorët qoftë makinat. Tutje informoj se komuna, ka ndërmarr të gjitha procedurat për shpronësimin e asaj pjese të parcelës, por se çështja është zvarriture tej mase nga ana e ministrisë së linjës. Komuna gjithashtu ka bërë kërkesë për vendosjen e semaforëve por kemi vonesa nga ministria për shkak të mos përgjigjes së tyre. Kryetari i komunës i ka përkrahur protesta dhe është shprehur i gatshëm që të marr pjesë në to. Ai sugjeroi kuvendit që të debatohet që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës- tha se çështja e problematikës së asaj rruge, është mirë të futet si pikë e rendit të ditës, që të adresohet kjo temë, por shtoj se fuqia e LVV-së për të ndikuar në nivelin qëndro është e madhe, dhe ata dëshiroj të dalin në opinion se e kanë rregulluar këtë problem.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se po të kishte mundësi ndikimi në ministrinë e linjës për vendosjen e semaforëve në atë rrugë, atë menjëherë do ta bënte. Por është për keqardhje qasja fyese e nënkryetarit të komunës, sepse sikur edhe fëmija e tij do të kalonin nëpër atë rrugë atëherë nuk do të kalkulonte kësisoj politikisht.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se qasja e nënkryetarit të komunës është banale, dhe ndihet keq një nënkryetar i tillë arrogant është përfaqësues i komunës së Vushtrris. Pastaj shtoi dhe adresoj sqarim me shkrim nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike lidhur me vijat me ngjyrë bardh dhe kaltër nëpër rrugët e qytetit në vendkalime, ku vlerësoi se sipas udhëzimit administrativë për sinjalizime neni 57 thuhet se: përveç në raste të veçanta vendkalimet mund të bëhen me ngjyrë të verdh, ngjyrat tjera nuk lejohen të vendosen sepse ato duhet të jenë të bardha. Andaj lidhur me këtë ajo pyeti cila ka qenë arsyeja për vendosjen e ngjyrave të tilla, nëse është bërë për hir të klubit të futbollit “Vushtrria” atëherë për këtë është dashur të mendohet më herët

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-lidhur me vendimin për rrënimin e objektit të ish-gjykatës komunale, sqaroi se kjo pikë ka qenë në rend dite edhe në muajin dhjetor 2020, dhe atë kohë ishte kërkuar që ajo pikë të shtyhet pasi që kishte ekzistuar një vendim tjetër për dhënien e asaj prone. Më pas sërish ishte riproceduar kjo çështje dhe ishte shfuqizuar vendimi për atë pronë. Çështja lidhur me këtë pronë dhe objekt ka marr analizën e duhur dhe janë shterur të gjitha debatet ashtu që në përfundim është nxjerr vendimi nga ana e kuvendit i cili është dërguar në MAPL për vlerësim, dhe është pikërisht anëtarja e kuvendit znj. Gresa Muli, e cila ka ndikuar tek kjo ministri për ta kthyer mbrapsht këtë vendim. Pas takimeve që kanë zhvilluar me zyrtaret e MAPL-së, ata e kanë kuptuar, që gabimisht kanë vepruar dhe zotimit i tyre ka qenë që ata nuk do të merren me këtë çështje. Më tej e njëjta anëtare e kuvendit znj. Gresa Muli nga radhët e LVV-së, ka iniciuar

takim me Ministrin e Kulturës, ku kërkon nga ky i fundit që të formohet një komision dhe që objekti në fjalë të fute nën mbrojtje. Komisioni i tillë formohet, dhe më pas Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore i fton në takim, ku ka marrë pjesë edhe një zyrtar nga DUMM-ja në Vushtrri dhe një zyrtar i LVV-së nga Drejtoria e Kulturës, ku është nxjerr konkluzioni se ka bazë që ai objekt të futet nën mbrojtje kulturore. Nga raporti i hartuar nga komisioni profesional del se objekti në fjalë nuk ka stabilitet statike dhe as të elementeve përbërëse armatura, tullat dhe çiment, dhe se edhe qeveria e kaluar ka planifikuar që ai objekt të rrënohet dhe zgjerohet sheshi “Adem Jashari”. Andaj ai përfundoj se kundërshtimi i këtij projekti është kryekrejtë çështje politike e orkestruar nga Lëvizja Vetëvendosje e cila po shihet qartë se i ka kapur institucionet e shtetit.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se nuk kërkoj përgjigje nga drejtori i DUMM-së, pasi ai nuk ka kompetencë të flasë, sepse kur ka qenë koha të flas nuk ka pasur guxim të dal para mediave që të flasë dhe tu jep përgjigje qytetarëve. Ajo pastaj vlerësoi vendimi për këtë çështje është antiligjor dhe edhe fillimi i procesit për rrënimin e këtij objekti është kundërligjor. Lidhur me takimet e saj me bartësi e institucioneve njoftoi se ajo është e lirë të takohet me këndo që ajo e vlerëson dhe se askush këtë nuk mund ta ndaloj dhe për më tepër kjo është tepër e ultë që dikush të merret se kush kënd e takon dhe me kënd bisedon. Lidhur me interesin e saj në këtë çështje, ajo njoftoi se këto janë të orkestruar nga pushteti aktual i komunës, përmes rrjeteve sociale fiktive të cilat nuk i bëjnë fare përshtypje. Në fund ceku se përse nuk merren me funksionalizimin e shkollës së muzikës, kur dihet se ata janë mbetur në një objekt bodrum, dhe merreni me rrënimin e objekteve, duke shfrytëzuar interesa dhe duke bërë ryshfet për lëshimin e lejeve për objektet me qira.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-tha se qeveria komunale iu përgjigjet qytetarëve e jo mediave, ndërsa ndërtimi i hapësirave publike, është planifikuar edhe me buxhetin e komunës për vitin 2021, e që lidhet edhe me ndërtimin e sheshit “Hasan Prishtina”. Pengesat që vinë nga LVV-ja lidhur me këtë projekt, lidhen me interesat e tyre se kujt duhet ti ja japin në shfrytëzim këtë objekt.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-kërkoj nga kryesuesi i kuvendit, që mbaj rendin në mbledhjen e kuvendi dhe të shikoj se kush po flet dhe si po flet. Ai bëri të ditur se nuk është Lëvizja Vetëvendosje ajo që bënë interpretimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të kuvendit, sepse kjo është kompetencë e MAPL-së. Lidhur me objektin e shkollës së muzikës njoftoi se ky objekt është në përfundim e sipër dhe ai do të jetë një objekt tepër i bukur që do ti jap hijeshinë qytetit të Vushtrrisë.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-vlerësoi se nëse këto tema të procedura me vonesë nuk janë tema urgjente, është mirë që të njëjtat të hiqen nga rendi i ditës, ashtu që kjo praktikë mos të përsërit sepse kështu për përkeqësohet zhvillimi i punës në mbledhjen e kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se disa nga pika e propozuar në të ndryshme vërtet janë të natyrës imediatet dhe duhet përkrahur që futen në rend të ditës, dhe shtoi se kjo praktikë e procedimit me vonesë të këtyre materialeve vërtet është shumë e dëmshme dhe është mirë që anëtarët e kuvendit më në fund e kanë kuptuar.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi se të gjitha propozim-vendimet që sillen në kuvend, fillimisht kalojnë nëpër filtrin e zyrës ligjore të komunës, ku konsultohen se a janë në përputhje me ligjin, dhe nëse përgjigja e zyrës ligjore është pozitive ato procedohen në kuvend. Tutej vlerësoi se nuk është praktik e mirë procedimi me vonesë i këtyre pikave, por arsyetoj se ka çështje që janë imediatet dhe të njëjta duhet procedohen po atë ditë që shfaqet nevoja. Ai kërkoj mirëkuptimin e kuvendit që pika e propozuara të futen në rend të ditës për shqyrtim, sepse janë çështje me rëndësi për qytetarët siç është ajo e memorandumit të mirëkuptimit me shoqatën Bamirës “Jetimat e Ballkanit” dhe propozimi për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim për KEDS-in.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se nuk është mirë të hedhet poshtë puna e zyrës ligjore, sepse tani para vetës kemi një vendim i cili duhet të rishqyrtohet, pasi që i njëjti ka referencë një ligj që tashmë është i shfuqizuar.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se zyra ligjore e komunës, materialet i filtron në aspektin, e përmbajtjes, ndërsa në aspektet teknike mund të gjenden gabime eventuale, por që këto nuk duhet ndikuar në aspektin material të aktit-vendimit, kjo duhet të jetë kështu që nga “Ligji i dymbëdhjetë tabelave” të Perandorit Justinian, dhe shtoi se kohëve të fundit MAPL-ja është bërë tepër përpiktë sa që edhe për çështje teknike po i kthen mbrapsht vendimet e kuvendit, kjo është e dëmshme dhe papranueshme sepse kështu pengohet puna e kuvendi dhe funksionimi i komunës.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 26 vota “për” 1 vota “abstenim” dhe 1 votë e “përmbajtur” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 prill 2021;
2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të Veprimit për dëgjime publike;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në menaxhim të parkingjeve publike të Komunës së Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje pa kompensim të pajisjeve dhe mjeteve të punës të komunës NPL-së “Përparimi” SH.A Vushtrri;
7. Shqyrtimi i propozimit të komisionit komunal, lidhur me çështjen e konstatimit të gjendjes faktike lidhur me Xhaminë e cila ndodhet në lagjen urbane “Kalaja” Rr. “Istref Haziri”;
8. Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimët e Ballkanit”;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 57/18 datës 22.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 01.Nr.67/21 i datës 25.03.2021 me të cilin lejohej dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme komunale;
11. Shqyrtimi i propozimit lidhur me gjendjen e sigurisë në rrugën magjistrale që lidhet me udhëkryqin e rrugës “2 Maji”;
12. Të ndryshme.
13. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 prill 2021;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, 1 votë e “përmbajtura” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 29 prill 2021.

2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se jemi në dijeni se ish-kryetari i komunës z.Bajram Mulaku, e ka refuzuar propozimin për t'iu ndarë titulli “nderi i qytetit” dhe këtë e ka bërë për arsye personale gjë për të cilën ata e kanë kuptuar drejt dhe e kanë konsideruar si çështje të mbyllur. Tutje shtoi se përkundër kësaj grupi kuvendar i Partisë Demokratike në konsultim edhe me grupet tjera kuvendare sot para fillimit të kësaj mbledhje të kuvendit, ka propozuar dhe ka dalë me kërkesën edhe të anëtarëve tjerë të kuvend që propozimi në fjalë lidhur me titullin “nderi i qyteti” të mbete si propozim dhe i një njëjti ti ndahet ish-kryetarit të komunës z.Bajram Mulaku, dhe ky propozim buron nga grupi kuvendar i PDK-së dhe i gjitha grupeve tjera kuvendare që kanë një dakordim të plotë lidhur me këtë çështje gjë për të cilën edhe i falënderon publikisht. Ai arsyetoi se Bajram Mulaku vërtet e meriton që ti ndahet ky titull, për kontributin që ka dhënë si ish kryetar i komunës, por edhe për kontributin e tij në jetën politike para dhe pas luftës, por edhe intelektual i urët dhe profesor universitar.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se vërtet i vijën shumë keq, por mendon se duhet respektuar qëndrimi i profesorit të nderuar z.Bajram Mulaku, i cili e ka refuzuar publikisht propozimin për titullin “nderi i qytetit” dhe deklaroi se nëse ky propozim do të del në votim grupi kuvendar i LVV-së do të jetë i përmbajtur.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se vërtet nuk e kupton qëndrimin e kolegut të tij nga radhët e PDK-së z.Azemi pasi që titulli “nderi i qytetit” është refuzuar publikisht nga i nominuari z. Bajram Mulaku, dhe vlerësoi se dikujt mund ti marrë diçka me preson dhe dhunë por jo edhe ti japësh, andaj pas një refuzimi të tillë ani nuk e sheh të arsyeshme që votohet një propozim i tillë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se duhet qartësuar disa gjëra, se titulli “nderi i qyteti” nuk i është ndarë z.Bajrma Mulaku, dhe ky i fundit nuk mund të refuzoj apriori një propozim të tillë. Pasi të votohet propozimi i komisionit për titullin “nderi i qytetit” Bajram Mulaku, atëherë mbetet në vullnetin e këtij të fundit që ta refuzoj apo të mos e refuzoj këtë titull. Ai vlerëson se këtë titull ai e meriton dhe i njëjti duhet të votohet.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-tha se profesori Bajram Mulaku, e meriton titullin “nderi i qyteti” për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij andaj kërkoi që ky propozim të votohet.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-tha se vërtet ka qenë një punë e vështirë në hartimin e listës për dekorata nga ana e komisionit, pasi që gjendemi në kushte të pandemisë, ku kemi humbur shumë njerëz dhe profesionit, andaj edhe shumica e të propozuarve për këto mirënjohje janë post-mortum. Tutje ajo dha sqarime sa i përket propozimeve të dala nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa ku janë propozuar të hartohen dy lista njëra për peronat personalitetit post-mortum dhe tjetra me figura të nderuar që janë në jetë. Në vazhdim ajo njoftoi kuvendin me emrat që janë propozuar nga të dyja listat e propozuara për mirënjohje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në mbledhjen e KPF-së ka pasur një pajtueshmëri që të bëhet shmangja e rregullores pasi që parashihet që vetëm dhjetë mirënjohje mund të ndaj kuvendi për një vit kalendarik. Megjithëkëtë të ndodhur në kushtet e pandemisë, komitetit ka vlerësuar që të hartohet një listë me nga dhjetë emra për personalitetit post-mortum dhe dhjetë emra nga lista për figurat që janë gjallë që kuvendi ti dekoroj me mirënjohje. Lidhur me propozimin e tij për dekorimin e dy policëve që kanë intervenuar në shuarjen e zjarrit bëri të ditur se për këtë rast është informuar nga mediat, dhe nga takimet që ka pasur me zyrtarët policor del se në intervenim ka marr pjesë një policë biografinë e të cilit e ka sjellë në komunë e që bëhet fjalë për Bahridin Tahirin.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se të gjithë të propozuarit në listë janë meritë për të ju ndarë mirënjohje dhe shtoi se në vitet e 80-dhjeta kontribut në aktivizëm qytetar në demonstrata e viti 1981 ka dhënë dy personalitete dy gra, që kanë mbajtur nga 60 ditë burg e të cilat meritojnë të nderohen me mirënjohje fjala është për Rahime Hajrizi/Hasani dhe Fatime Jashari/Shaqiri.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit-duke korrigjuar parafolësin e saj tha se në demonstrata e vitit 1981 kishin marr pjesë tri gra dhe atë Fatime Shaqiri, Zoja Shaqiri dhe Luljeta Salihu ajo rikonfirmoj propozimin që këtyre t'iu ndahen mirënjohjeje.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-propozoi për mirënjohje znj.Fikrije Badivukun për kontribut në fushën e arsimit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi se lidhur me shpërthimin e zjarrit në Spitalin "Sheikh Zayed", ku janë shkatërrua disa pajisje medicinale, akoma nuk kemi raport zyrtar nga policia, andaj ai vlerësoi se fillimisht duhet sqaruar se kush ka qenë i involvuar në këtë rast e më tej të ndahet mirënjohje për atë policë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha secili propozim për mirënjohje i bërë nga anëtarët e kuvendit veçanërisht duhet të jetë i arsyetuar me shkrim ashtu që ti mundësohet Sekretarisë së Kuvendit që të njëjtin tekst ta inkorporoj në vendim.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-kërkoi që të përmirësohet emri i të propozuarës për mirënjohje nga Fora në Florije Shabani, këtë propozim e arsyetoj dhe ceku se është meritë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha të gjitha propozimet e bëra nga partitë politike, duhet të ishin dërguar me arsyetim me shkrim dhe me biografi ashtu që të dimë se për kënd jemi duke votuar, kështu do të lehtësohej puna e kuvendit. Ai përmendi një grua e quajtur Hatixhe Morina-Asllani, që ka kontribuar dhe ka qenë një grua heroin dhe emri i saj meriton të lartësohet duke u vendosur në emërtim të ndonjë rruge.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-konfirmoj se polici Bahridin Tahiri ka marrë pjesë në shuarjen e zjarrit dhe evitimin e rrezikut në spitalin e qytetit.

Fitim Halili, anëtar i kuvendit-propozoi për mirënjohje Sadik Halilin- për kontributin e dhënë në luftën për çlirim, invalid i UÇK-së.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-propozoi për mirënjohje, Metije Gërxhaliu, për shërbim të pakursyer në përgatitjen e ushqimit për ushtarët e UÇK-së, e cila në luftë humbi birin dhe burrin e saj.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-lexoj emrat e propozuar për mirënjohje që janë bërë nga Komitetit për Politikë dhe Financa, nga komisioni për dekorata si dhe emrat e propozuar nga anëtarët e kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se pasi që ka pajtim për shmangien e rregullores, propozoi që të gjitha propozimet e bëra të votohen në pako.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit- në rekapitullimin e debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës hodhi në votim listat për mirënjohje të hartuara nga komisioni për dekorata, propozimet nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe propozimet e bëra nga anëtarët e kuvendit.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të "Ditës së Çlirimit të Vushtrisë", më 17 qershor ndan këto mirënjohje:

- 1.1 **AQH** (Accessible Quality Healthcare)– Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë ;
- 1.2 **Hajzer Beqiri** – (pas vdekjes), për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, babai i heroit Bastri Beqiri;
- 1.3 **Lulëzim Krasniqi** – (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si luftëtar i UÇK-së;
- 1.4 **Besim Shyti** –për kontributin e dhënë si luftëtar i UÇK-së;
- 1.5 **Hajullah Saraçi**- (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si mjek, ish-drejtor i spitalit në Vushtri;
- 1.6 **Mihane Kadriu** – për sakrificën e familjes e cila gjatë luftës së UÇK-së për çlirim, humbi bashkëshortin dhe dy djemtë e saj;
- 1.7 **Jakup Neziri** – (pas vdekjes) për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;
- 1.8 **Shaip Azemi** – (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si ish-punëtor i arsimit;
- 1.9 **Nebahate Zahiti** – (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si infermiere në QKMF;
- 1.10. **Ferat Isufi** -(pas vdekjes) punëtor i dalluar teknik në QKMF;
- 1.11. **Jusuf Hajredinaj**- (pas vdekjes) për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;
- 1.12. **Shaqir Musliu**- (pas vdekjes) për kontributin dhënë si veteran në luftën e UÇK-së;
- 1.13. **Ferki Rashica**- (pas vdekjes) për kontributin e dhënë për klubin e futbollit “Kosova e Vushtrisë”;
- 1.14. **Zenel Bunjaku**-për kontributin e dhënë në zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe bujqësisë;
- 1.15. **Flora Shabani**- për kontributin e dhënë në biznese dhe për bashkëpunim shembullor me Grupin e Grave Asambliste të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë;
- 1.16. **Bahridin Tahiri**- ish pjesëtar i UÇK-së, dhe zyrtar policorë, për kontributin e dhënë në reagim profesional në shuarjen e zjarrit në Spitalin "Sheikh Zayed" në Vushtri;
- 1.17. **Ajmane Ferati**-për kontributin e dhënë në administratën e komunës, familjare e martirit në luftën e UÇK-së;
- 1.18. **Sadik Halili**- për kontributin e dhënë në luftën për çlirim, invalid i UÇK-së;

1.19. Metije Gërxhaliu, për shërbim të pakursyer në përgatitjen e ushqimit për ushtarët e UÇK-së, e cila në luftë humbi birin dhe burrin e saj;

1.20. Fikrije Badivuku-Hoti- për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;

1.21. Fatime Jashari/Shaqiri- për aktinizëm të dalluar qytetarë kundër okupatorit serb në demonstrata e vitit 1989;

1.22. Zoja Shaqiri- për aktinizëm të dalluar qytetarë kundër okupatorit serb në demonstrata e vitit 1989;

1.23. Rahime Hajrizi/Hasani- për aktinizëm të dalluar qytetarë kundër okupatorit serb në demonstrata e vitit 1989;

1.24. Luljeta Salihu- për aktinizëm të dalluar qytetarë kundër okupatorit serb në demonstrata e vitit 1989;

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera kompetentet komunale.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me titullin “Qytetar Nderi” i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021, kuvendit i komunës pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, z.Enver Oruçaj, ish komandant i Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i ndahet titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Vushtrrisë, për kontributin e madh të dhënë në veprimtari kombëtare dhe atdhedashuri si dhe sakrificë në luftën për çlirimin e vendit.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës me datën 17 qershor Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit-deklaroi se, z Bajram Mulaku, ka qenë pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës, dhe i njëjti e ka refuzuar propozimin e bërë për titullin “nderi i qytetit” ai ka qenë kryetari i komunës nga radhët e PDK-së e jo nga ndonjë parti tjetër andaj si rezultat i refuzimit të tij, grupi kuvendar i PDK-së do të përmbahet nga votimi i këtij propozimi.

Lidhur me titullin “ Nderi i Qytetit” i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021, kuvendit i komunës pas votimit me 19 vota “për” 1 votë “abstenim” të tjerat të përmbajtura vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, z.Bajram Mulaku nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet titulli “Nderi i qytetit”, për kontributin e tij dhënë për Vushtrrinë, si intelektual dhe si ish-kryetar i Komunës së Vushtrrisë.
 2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
 4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-kërkoi që emrat e propozuar për këtë komision të iu bashkëngjitet nga një CV e këtyre të propozuarve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se procesi i zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë, duhet të bëhet sipas legjislacionit në fuqi Ligjit për arsimin Parauniversitarë dhe në pajtim me parimet siç janë: parimi i ligjshmërisë dhe depolitizimit, parimi i meritokracisë dhe kompetencës profesionale, parimi i transparencës dhe bashkëpunimit institucional, parimi i paanësisë mundësive të barabarta dhe mos diskriminimit dhe parimi i barazisë gjinore. Këto parime duhet të jenë pika referuese, të punës së këtij komisioni që do shërbejnë për përzgjedhjen dhe për vendimmarrësit për emërimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave. Anëtar i parë duhet të jetë i punësuar në DKA dhe duhet të jetë kryesuese i komisionit, anëtar i dytë po ashtu i propozuar nga DKA mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësuese nga këshilli i prindërve me kualifikim të lartë dhe ekspertizë në fushën e edukimit po ashtu pjesëmarrës gjatë këtij procesi duhet të jenë dy përfaqësues nga Këshilli Drejtues në cilësinë e vëzhguesve një prind dhe një mësimdhënës. Neni 6 pika 7 e Udhëzimit Administrativ nr.151/2021 përcakton anëtarët e MASH dhe DKA duhet të kenë së paku një kualifikim të barasvlefshëm me kërkesat për kualifikim të kandidatëve për pozitë të drejtorit/zëvendës drejtorit si dhe përvoja në arsim së paku tri vite. Nga kjo është mirë të dimë se cilat janë përgatitjet profesionale të këtyre anëtarëve të propozuar për komision, kjo për faktin se a do mund të ndodh që një anëtar i komisionit me përgatitjet themelore universitare të intervistoj një kandidat për drejtor me titull master/magjistër apo doktor i shkencave në këtë drejtim duhet të kemi informata të sakta. Po ashtu neni 10 i këtij udhëzimi administrativ thotë: punëdhënësi ka të drejtë që pas dy-tri vazhdimëve të kontratës në të njëjtin institucion edukativo-arsimor, bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës, të vendos për vazhdimin e kontratës vijuese, pa konkurs, në të njëjtin apo në një institucion tjetër edukativo-arsimor në nivel të komunës. Për këtë pyeti DKA-në se a kemi ndonjë rast të tillë, kjo për faktin se edhe pse arsimit

nuk është në gjendje të mirë, prapëseprapë kemi drejtor me rezultatet të mira ti cilëve do të mundemi të iu vazhdohet mandati edhe për katër vite tjera.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se duke u bazuar në udhëzimin administrativ, ku kërkohet si kriter përvoja e gjatë në udhëheqje të institucioneve edukativo-arsimore, që të jetë anëtari i komisionit, ceku se personi i propozuar nuk ka përvojën e duhur të kërkuar sipas legjislacionit dhe si tillë nuk i plotëson kushte ligjore që të jetë pjesë e komisionit. Andaj këndvështrimi i tij është që anëtari i komisionit nga institucioneve arsimore duhet të jetë sipas niveleve të shkollave, nëse bëhet fjalë për drejtor të shkollës së mesme të ulët atëherë të jetë po nga ajo kategori edhe anëtari i komisionit. Në rastin konkret është propozuar një drejtoreshë e cila nuk i plotëson kushtin e përvojës menagjeriale sipas dispozitave ligjore e cila akoma nuk e ka kaluar stazhin e praktikantes dhe ajo do të merret me përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave të mesme. Andaj ai propozoi që ky komision të jetë për inervistimin të kandidatëve vetëm për një shkollë ndërsa për shkollat tjera të kemi komision tjetër. Në rastin konkret për shkollat: "Nazmi Zhegrova "Stanoc i Poshtëm, SHFMU "Lumni Surdulli "Samadrexhë, SHFMU" Rilindja "Maxhunaj, SHFMU "Emin Duraku "Novolan dhe Drejtor në SHFMU "Bajram Curri "Dumnice e Llugës , anëtar i komisionit të jetë Ferki Përçuku.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës-tha se anëtarët e propozuar nga DKA-ja për shqyrtimin e konkurseve, i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret kemi Hashim Hajrizin, anëtar që është jurist me përvojë të gjatë dhe pjesë e stafit të DKA-së por edhe me përvojë në institucionet arsimore. Anëtarja e dytë e propozuar znj.Ardita Bekteshi, i plotëson po ashtu kushtet pasi që udhëzimi administrativ kërkon përvojë arsimore por që nuk specifikohet në vite. Ajo ka përgatitëj universitare bachelor me 240 kredi që është minimumi i nevojshëm i kriterit për tu punësuar në një shkollë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, dhe kjo e bënë atë që ti plotëson kushtet ligjore për të qenë pjesë e komisionit. Sa i përket çështjes së vazhdimit të mandatit të drejtorëve që kanë dhënë rezultate të larat në udhëheqje gjë e cila mundësohet me udhëzim administrativ, shtrohet pyetja se kush do ta bënte vlerësimin e performancës së atyre drejtorëve, këtë duhet ta bëjë inspektorati i arsimit në vitin e fundit të mandatit të atij drejtori, andaj deri më tani nuk kemi vlerësime të tilla nga ana e inspektoratit, dhe është vendim i inspektoratit që të gjithë drejtorët që iu skadon mandati nuk mund të iu vazhdohet kontrata pa ju nënshtruar kushteve të konkursit. Deri në fund të këtij viti kalendarik po thuajse të gjithë drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve do tu skadojë mandati dhe do të jetë e vështirë që të gjithë këta të marrin vlerësim nga inspektorati deri në fund të këtij viti. Në fund përsëriti se komisioni në fjalë i përmbushë të gjitha kushtet ligjore dhe ato të përbërjes gjinore andaj propozoi që ky propozim-vendim të aprovohet.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 14 vota "për" 10 vota "kundër" 1 votë "abstenim" të tjerat të përmbajtura vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: Drejtor në SHF" Mustafë Venhari" dhe Drejtor në SHF "Naim Frashëri" në Komunën e Vushtrisë, me këtë përbërje:

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personelit i DKA-së
- 1.2. Ardita Bekteshi, drejtoreshë në SHFMU" Migjeni "Stanoc i Epërm
- 1.3 _____, përfaqësues i MASHT-it.

2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: Drejtor në Gjymnazin "Eqrem Çabej" dhe Drejtor në SHMP "Bahri Haxha" në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personelit i DKA-së

1.2. Ardita Bekteshi, drejtoreshë në SHFMU "Migjeni" Stanoc i Epërm

1.3 _____, përfaqësues i MASHT-it.

~~2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.~~

~~3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit.~~

~~4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.~~

~~5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.~~

~~1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: Drejtor në SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë, SHFMU "Bahri Kuqi" Shtruer, SHFMU "Nazmi Zhegrova" Stanoc i Poshtëm, SHFMU "Lumni Surdulli" Samadrexhë, SHFMU "Rilindja" Maxhunaj, SHFMU "Emin Duraku" Novolan dhe Drejtor në SHFMU "Bajram Curri" Dumnicë e Llugës, me këtë përbërje:~~

~~1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personelit i DKA-së~~

~~1.2. Ardita Bekteshi, drejtoreshë në SHFMU "Migjeni" Stanoc i Epërm~~

~~1.3 _____, përfaqësues i MASHT-it~~

2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: Zëvendës drejtor në SHMT "Lutfi Musiqi" në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personelit i DKA-së

1.2. Ardita Bekteshi, drejtoreshë në SHFMU "Migjeni" Stanoc i Epërm

1.3. _____, përfaqësues i MASHT-it

2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2021 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të Veprimit për dëgjime publike;

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit, ku ceku se qarkorja buxhetor është dokument që lëshohet nga Ministria e Financave për kufijtë buxhetor për të gjitha organizata buxhetore. Ai paraqiti shifra konkretet krahasuese për buxhetin e komunës për vitin 2020 krahasuar me buxhetin e këtij viti. Lidhur me dëgjimet buxhetore propozoi që të mbahen online por edhe përmes dërgimit të kërkesave në organet e administratës komunale.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet që dëgjimet buxhetore të mbahen në formën online për shkak të pandemisë, dhe shtoi se duhet të caktohet afati brenda të cilit qytetarë do të mund të parashtrajnë kërkesat e tyre. Tutje shtoi se nga dëgjimet buxhetore të mbajtura në vitin 2019 kërkesat e qytetarëve që kanë dal nga këto dëgjime nuk janë marrë për bazë nga qeverisja

komunale dhe kryetari i komunës. Në dëgjimin buxhetor në fshatin Smrekonicë, ka qenë kërkesa për asfaltimin e rrugës “Lutfi Mustafa” kjo nuk është realizuar, në fshatin Novolan asfaltimi i rrugës “Ahmet Delia” nuk është realizuar, në fshatin Druar, ka qenë kërkesë rregullimi kroit të fshatit dhe kjo kërkesë nuk është realizuar, në fshatin Maxhunaj ka qenë kërkesë asfaltimi i rrugës “Drita” nuk është realizuar, në fshatin Samadrexhë asfaltimi i rrugës “Beteja e Loxhës” nuk është realizuar, në fshatin Stanoc i Epërm rregullimi i trotuarit në rrugën “Dalip Maloku”, pastaj asfaltimi i rrugës “Bajram e Selim Caka” nuk është realizuar, në fshatin Reznik asfaltimi i rrugës “Shëmsi Zeneli” kërkesa nuk është realizuar. Në qytetin e Vushtrrisë nga dëgjimi buxhetor kanë dal kërkesat si: asfaltimi i rrugës “Tefik Krasniqi”, nuk është realizuar, kjo është një praktikë e keqe e mos respektimi të kërkesave të qytetarëve, e cila duhet larguar ashtu që kërkesat e qytetarëve së paku në masë të konsideruar të plotësohen. Në fund pyeti se a është në projekt për vitin 2021 rregullimi i rrugës Sllakoc-Kurillov në gjatësi prej 4 km, ku mjetet financiare në masën 90 % janë ndarë nga granti qeveritar, ndërsa 10 % nga mjetet e komunës, për këtë pyeti se deri ku kanë shkuar procedurat për zhvillimin e këtij projekti.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se për dëgjimet buxhetore, duhet të lihet i hapur edhe opsioni i mbajtjes së tubimeve në formë fizike, për shkak të heqjes së masave kundër pandemisë covid-19.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se rruga Sllakoc-Kurillov, ka një gjatësi prej 7 km, ndërsa mbulimi i kostos financiare të kësaj rruge, është 10,000.00 € nga të hyrat komunale, ndërsa 90,000.00 € nga granti qeveritar, projekti për këtë rrugë është hartuar, ndërsa kostoja totale e kësaj rruge parashihet të jetë rreth 500,000.00 €, si qeverisje komunale do të shikohet mundësia se do veprohet lidhur me këtë projekt. Lidhur me kërkesat nga dëgjimet buxhetore njoftoi se atë të mbulohen sipas kapaciteteve financiare të komunës dhe sipas prioritetit të nevojave qytetare të shpërndara në gjithë territorin e komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-lidhur me ndërtimin e një rezervari të ujit të pijes i cili është duke u ndërtuar në fshatin Dumnicë e Poshtem, pyeti se ky rezervar a do të shërbej vetë për fshatin Dumincë, apo edhe për fshatrat tjera në të cilat nuk ka ujë të pijes dhe ka vështirësi si p.sh në fshatin Stanoc i Epërm

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se stacioni i pompimit në fshatin Dumincë e Poshtme do të shërbej për fshatrat e Dumnicës, dhe për fshatin Stanoc i Epërm do të shikohet mundësia përmes baster-pompave të mbulohet edhe ajo pjesë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se lidhur me dëgjimet buxhetore kuvendi, nuk fare nevojë votoj, pasi që kjo çështje i takon Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e cila duhet të hartoj plani e dëgjimeve buxhetore.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **27 maj 2021**, pas shqyrtimit të Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022 dhe miratimin e Planit të Veprimit për Dëgjime Buxhetore, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i parashtron këtë:

REKOMANDIM

Duke marrë parasysh gjendjen me pandeminë Covid-19, kuvendi i komunës ka rekomanduar që dëgjimet buxhetore me qytetarë lidhur me planifikimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022, ti zhvilloj sipas formave të cekur si në vijim:

I Qytetarët e Komunës së Vushtrrisë mund të deklarohen në formë online për adresimin e kërkesave për projekte kapitale në një link të krijuar nga ana e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

II Qytetarët e Komunës së Vushtrrisë kërkesat e tyre lidhur me projektet për investime kapitale mund ti dërgojnë në formë elektronike në adresat elektronike:

lutfi.gerguri@rks-gov.net
sekretaria_kkvush@yahoo.com

III Qytetarët, kërkesat e tyre për projektet kapitale, të cilat do të inkorporohen në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022, mund ti dërgojnë në kopje fizike në arkivin e Komunës së Vushtrrisë përmes kryetarëve të fshatrave.

Kërkesat për projekte kapitale të cilat do të inkorporohen në draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022 do të mund të parashtrihen në bazë të afati të përcaktuar nga ana e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në menaxhim të parkingjeve publike të Komunës së Vushtrrisë;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se këto parkingje janë dhënë në shfrytëzim në vitin 2016 për një afat 5 vjeçar, për këtë pyet se a janë zhvilluar të gjitha procedurat e atyre që i kanë pasur në menaxhim të njëjta a i ka dorëzuar në komunë, dhe se për këtë arsye kishte me qenë mirë që për një pikë kaq të rëndësishme të jetë i pranishëm edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për të dhënë sqarimet e nevojshme. Ai vlerësoi dhe kërkoi mendimin e kësaj të fundi se a kemi zyrtarisht përfundimi të kontratës mes Komunës së Vushtrrisë dhe atyre operatorëve që i kanë pasur në menaxhim këto parkingje, ashtu që ti shmangemi ndonjë pasoje juridike me anë të padive gjyqësore ndaj komunës.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se para se ta votojmë këtë pikë të rendit të ditës, duhet të kemi analiza mjaftë të kujdesshme, kjo për faktin që komuna më vonë mos të ketë pasoja që ti merren paratë nga ndonjë vendim i cili i në kundërshtim me in tresin e komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se është në dijeni se ka qenë e lidhur një kontratë me një operator ekonomik dhe komunës, për menaxhimin e këtyre parkingjeve, por që ajo kompani është tërhequr më vonë nga kontrata, por a ka efektet tjera juridike nga kjo kontratë atëherë kjo është çështje tjetër. Ai vlerëson se kuvend duhet ta mbështesë këtë pikë duke e aprovuar, sepse lidhet me hapjen e vendeve të reja të punës dhe me funksionalizimin e Kompanisë "Përparimi". Ai propozoi që në tekstin e vendimit të futet që shfuqizohen të gjitha vendimet që lidhen me këtë materie apo fushë, që ka të bëjë me dhënien në menaxhim të parkingjeve publike në Komunën e Vushtrrisë.

Adnan Lahu, drejtor, DGJKP-së-tha se kontrata e më hershme me operatorin ekonomik për dhënien e këtyre parkingjeve publike në menaxhim është ndërprerë, atëherë në këtë kontekst nuk

kemi kurrfarë problemi që të veprojmë më tutej për të bartur në menaxhim këto parkingje tek Kompania “Përparimi”.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim i jepen në menaxhim pa kompensim, Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri të gjitha parkingjet publike në Komunën e Vushtrrisë.

2. Ndërmarrja Publike Lokale “Përparimi” SH.A, menaxhimin e parkingjeve do t’i bëj konform Rregullores në fuqi për Menaxhim të Parkingjeve Publike në Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: NPL “Përparimi” SH.A në Vushtrri, në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Drejtorinë e Inspektimeve.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01Nr. 74/16, datë 28.04.2016 për dhënien në menaxhim të parkingjeve publike.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje pa kompensim të pajisjeve dhe mjeteve të punës të komunës NPL-së “Përparimi” SH.A Vushtrri;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky vendim duhet të plotësohet, ashtu që asetet e bartura nga komuna të regjistrohen në emër të Kompanisë “Përparimi” që mos të mbesin edhe më tutej të regjistruar në emër të komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se duhet sqaruar se këto mjetet ndërmarrjes në fjalë, apo i jepen në shfrytëzim, apo po i kalojmë në pronësi të ndërmarrjes “Përparimi”, kjo është mirë të dihet sepse duhet sqaruar se për këtë çështje a duhet pasur referencë Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ai tha vlerësoi se për një çështje kaq të rëndësishme, duhet të jetë prezent drejtori i DSHP-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim i barten pa kompensim pajisje dhe mjete të punës pronë e komunës së Vushtrrisë, Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri, si në vijim:

1.1 Automjet transporti (02Z-13-27).....një (1) copë;

1.2 Cisternë plastike me kapacitet 1000 litra.....një (1) copë;

1.3 Rezervuar uji i plastikes me kapacitet 1000 litra.....një (1) copë;

- 1.4 Kositëse të barit vetëlëvizëse me benzinë (villager).....dy (2) copë;
- 1.5 Kositëse të barit TRIMER me sajl (sillt).....pesë (5) copë
(4 prej tyre defekt dhe 1 në gjendje të rregullt);
- 1.6 Shkallë 10. m. Gjatësi (alumin).....një (1) palë;
- 1.7 Pompa krahu për dezinfektimdy (2) copë;
- 1.8 Flamuj Kombëtar dhe Shtetërorë.....nëntëdhjetë (90)
copë.

2. Mjetet dhe pajisjet e cekura si në pikën 1 të këtij vendimi barten në pronësi dhe regjistrohen si aset në emër të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe NPL “Përparimi” në Vushtrri.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i propozimit të komisionit komunal, lidhur me çështjen e konstatimit të gjendjes faktike lidhur me Xhaminë e cila ndodhet në lagjen urbane “Kalaja” Rr. “Istref Haziri”;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se pas takimeve që kanë pasur me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri dhe komandantin e Policës në Vushtrri është arritur një pajtueshmëri që ai objekt me destinim Xhami të mos përdoret më tej për këtë qëllim, dhe falja e namazit dhe riteve fetare të mos bëhet më tej aty dhe pajtimi është që të gjendet një pronë-parcelë, për ndërtimin e një xhamie me parkingje dhe me kushte moderne. Ideja e tij është që atyre tu ndahet një pronë por jo të shkohet në proceduar e kompensimit sepse kjo do ta zvarrite pafundësisht zgjidhjen e kësaj problematike. Ai ceku se ka zotime se projekti ideor i ndërtimit të Xhamisë do të silltet në kuvend për shqyrtim kështu kanë premtuar drejtuesit e Bashkësisë Islame, andaj pasi ekziston pajtimi i të gjitha grupeve kuvendare propozoi që rekomandimi në fjalë të aprovohet.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se rekomandimi i komisionit del se është një marrëveshje mes Këshillit të Bashkësisë Islame dhe komisionit por që është antiligjor. Pastaj pyeti drejtorin e Drejtorisë për Pronë se parcela kadastrale me Nr.2253-5 a është pronë e komunës parcelë e cila është ofruar si lokacion për ndërtimin e Xhamisë, e që nëse del që nuk është pronë e komunës atëherë komuna nuk ka të drejtë që japë në shfrytëzim apo këmbim me Bashkësinë Islame. Ndërsa ai propozoi që të shkohet me këmbim të pronës mes komunës dhe Bashkësisë Islame.

Adnan Lahu, drejtor, DGJKP-së-sqaroi se në pikën dy të rekomandimit ceket se në pronës të kujt gjendet parcela e propozuar dhe se prona në fjalë gjendet në pronësi të AKP-së, por që për këto prona e kemi një vendim nga ish-kryeministri Haradinaj që këto prona ti kthehen Komunës së Vushtrrisë, dhe se komuna ka bërë kërkesë që të gjitha këto prona të kthehen në pronësi të Komunës së Vushtrrisë, është kryer vlerësimi në zyrën për vlerësim në ministrinë e linjës, tani kanë mbetur disa veprime procedurale, të një pagese ndaj ATK-së për tu bartur pronësia tek Komuna e Vushtrrisë. Ajo çka duhet potencuar është fakti se këto prona nuk mund të futen në

listën e pronave për privatizim, nga AKP-ja, pasi janë prona të Komunës së Vushtrrisë, dhe më e rëndësishmja është se komuna, në këto prona ka të drejtën që zhvilloj projekte me interes publik. **Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-pasi falënderoi komision për punë që ka bërë, vlerësoi se është një fillim i mbarë për ta zgjedhur problemin e kamotshëm në lagjen urbane “Kalaja” dhe është i pajtimi që në proces të bëhet këmbimi i pronës mes komunës së Vushtrris dhe Bashkësisë Islame. Rasti konkret i këmbimit do të mund të ishte që një pronë e Bashkësisë Islame tek rruga e Gojbulës, do të mund të merrej nga komuna për ndërtimin e ndonjë çerdhe, ndërsa prona tjetër të këmbëhet për ndërtimin e Xhamisë nga Bashkësia Islame.

Në fund të debatit lidhur m këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **27 maj 2021**, pas shqyrtimit të propozimit të komisionit komunal, lidhur me çështjen e konstatimit të gjendjes faktike lidhur me Xhaminë e cila ndodhet në lagjen urbane “Kalaja” Rr. “Istref Haziri” Nr. 9, pas debateve dhe analizës së hollësishme aprovon këtë:

REKOMANDIM

I Nga konsultat paraprake rezultoi se:

Objekti i cili aktualisht përdoret për faljen e namazit në rr. “Istref Haziri”-Vushtrri *nuk i plotëson* kushtet e parapara për të vazhduar edhe më tutje funksionin e Xhamisë këtë konstatim e dha në komision Kryetari i Bashkësisë Islame- Vushtrri z. Shemsi Rrahimi, i cili u zotua dhe që kemi arritur dakordancën e plotë se do të bashkëpunoj ngushtë me komunën, gjegjësisht Drejtorin e Inspektionit po në rast nevojë edhe me Policinë e Kosovës dhe do ti bashkërendisin veprimet në mënyrë që ky objekt nga dita e votimit të këtij Rekomandimi në Kuvend tutje nuk do përdoret dhe nuk do të lejohet të përdoret për faljen e namazit dhe as nuk do të përdoret për rite fetare, pasi që i njëjti objekt nuk plotëson gati asnjë kriter të domosdoshëm për të shërbyer si Xhami.

II Kuvendi Rekomandon:

Që mbi bazën e të cekurave në pikën 1 të këtij Rekomandimi dhe duke pasur parasysh kërkesën e Kryetarit të BI për ndarjen dhe caktimin e një lokacioni (mundësisht në atë zonë), për ndërtimin e një Xhamie me standarde të larta si në arkitekturën ashtu edhe në infrastrukturën e përgjithshme Drejtoria për Kadastër dhe komisioni kanë përzgjedhur një pronë – parcelë kadastrale e cila nga Kuvendi Komunal është shpallur zonë me interes të përgjithshëm dhe aktualisht kjo pronë dhe disa prona tjera janë në fazën e kthimit në pronësi të Komunës.

III Kuvendi i Rekomandon Kryetarit dhe Qeverisë Komunale

Që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore që të mundësoj kthimin në pronësi të disa pronave të cilat janë në procedurë të kthimit të pronësisë të Komunës së Vushtrrisë nga AKP-ja (bëhet fjalë për afro 5 ha prona në zona të ndryshme), duke dhënë edhe Letër-Zotimi për përmbushjen e obligimeve që derivojnë nga kjo bartje pronësie.

IV Autorizohet Qeveria komunale gjegjësisht Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të ndërmerret veprimet e cekura si dhe nënshkrimin e marrëveshjes me BI-Vushtrri për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës (parcelës), komunale ekskluzivisht për ndërtimin e Xhamisë me

infrastrukturë komplete. Gjithashtu qeveria komunale gjegjësisht Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë duhet ti shikoj mundësitë dhe ti zhvilloj procedurat ligjore për këmbimin e ndonjë prone mes Komunës së Vushtrrisë dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri, që lidhet me qëllimin e ndërtimit të Xhamisë, por duke shikuar edhe aspektin e përfitimit të komunës, pasi që është evidente se komuna ka mungesë të pronës në pronësi të saj.

ARSYETIM

Komisioni i përbashkët kuvend-qeveri komunale lidhur me konstatimin e gjendjes faktike sa i përket Xhamisë e ndodhur në Lagjen Urbane “Kalaja” në përbërje të plotë ka mbajtur takimin paraprak konsultativ me Kryetarin e BI-Vushtrri, Komandantin e Stacionit Policor-Vushtrri dhe nënkryetarin e komunës.

Kurse me datën 26/05/2021 Komisioni shqyrtoi gjendjen faktike të Xhamisë në Lagjen urbane “Kalaja” Rr.”Istref Haziri” Vushtrri, ku mori në konsideratë edhe konsultat paraprake me përfaqësuesit relevant të institucioneve të përmendura dhe nga të gjeturat në terren, hartoi rekomandimin e cekur si më lartë.

Kuvendi i komunës duke u bazuar në propozimet e komisionit, i ka marrë në konsideratë dhe i ka adresuar shqetësimet banorëve të Lagjes Urbane “Kalaja”, dhe obligon qeverinë komunale që të veprojë në zhvillimin e procedurave ligjore për ta zgjidhur çështjen në fjalë, duke hyrë në procesin e ndërrimit/ këmbimit të pronave mes Komunës së Vushtrrisë dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri.

8. Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimët e Ballkanit”;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet memorandumit i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimët e Ballkanit”, për financim të përbashkët të Projektit-ndërtimi i Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuarit në Komunën e Vushtrrisë.
2. Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është financimi i Projektit-“ndërtimi i Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuarit në Komunën e Vushtrrisë” dhe përcaktimi i obligimeve të palëve për realizimin e këtij projekti.
3. Autorizohet Kryetari i komunës që t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t’i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale, që kanë të bëjnë me sferën e zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshje.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 57/18 datës 22.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 57/18 datës 22.02.2018 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim:

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.3 në vend të z.Afrim Namanit, emërohet znj.Ragbete Krasniqi;

1.2 Në pikën 1.4 në vend të z.Bajrush Kosumit, emërohet z.Enis Maxhuni.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 01.Nr.67/21 i datës 25.03.2021 me të cilin lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme komunale;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se në vendim duhet të ceket ndryshimi dhe plotësimi i vendimit sipas instruksioneve të dhëna nga MAPL-ja.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.67/21 i datës 25.03.2021 me të cilin lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për katër dhjetë e pesë (45) vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë e cila gjendet në ngastrën kadastrale Nr.P-028K-0 Zona Kadastrale Gojbulë e cila përfshinë një sipërfaqe prej 25m² të marr nga sipërfaqja e përgjithshme 5675m² pronë e Komunës së Vushtrrisë, ashtu që ndryshimi i vendimit të cekur më lartë konsiston në dhënien e pronës me kompensim përkatësisht me çmim vjetor prej gjashtëqind euro (600 €) për vit.

2. Ngastra kadastrale e cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite KEDS-it për vendosjen e trafostacionit shpërndarës (blindë) në sipërfaqe prej 4.4 x 2.2 m².

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Pjese e këtij vendimi janë: certifikata e pronësisë, kopja e planit dhe skicat e projektit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë .

11. Shqyrtimi i propozimit lidhur me gjendjen e sigurisë në rrugën magjistrale që lidhet me udhëkryqin e rrugës “2 Maji”;

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se ka marrë peticionin e banorëve të fshatit Studime e Poshtme, rruga “2 Maji ” të cilët kërkojnë që sa më parë të vendosen semaforët në udhëkryqin mes kësaj rruge dhe rrugës magjistrale. Ai njoftoi se ka biseduar me ata banor të cilët janë zotuar se do të protestojnë dhe bllokojnë rrugën dhe po ashtu kërkojnë që ky problem të adresohet në kuvend dhe ministrinë e linjës që kompetente për këtë çështje.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se i ka shterur të gjitha konsultat me ministrinë e linjës dhe ka kërkuar disa herë nga ta që të bëhet vendosja e atyre semaforëve ashtu që të mënjanohet rreziku për qytetarët. Ai sqaron se ministria do të mundte që nga kontrata për sinjalizime të bënte mbulimin e kostos financiare për vendosjen e atyre semaforëve. Tutje shtoi se ai do ti përkrah qytetarët në çdo hap qoftë edhe duke iu bashkëngjitur në protesta pasi e drejta është plotësisht në anë e tyre. Ai ceku se me para të komunës është shpronësuar një pjesë e një parcele vetë e vetëm që ky projekt të ecë përpara. Andaj ai përfundoj se kjo çështje e vendosje së semaforëve është çështje ekskluzive e ministrisë, por mos veprimi i tyre është bërë irritues dhe i pakuptimit.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-kërkoj nga kryetari i komunës që deri në vendosjen e semaforëve në atë udhëkryq të jenë të vendosur policia.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se është në projekt që ndriçimi publik do të bëhet deri në Studimen e Epërme, dhe komuna edhe pse nuk ka bërë pompozitet ka ndarë buxhet për rregullimin e varrezave të dëshmorëve. Po ashtu edhe ujesjellësit do të përfundoj për atë pjesë. Lidhur me vendosjen e policës ai u zotu se do ti parashtrij kërkesë komandantit të stacionit policor në Vushtri.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

I nderuar ministër,

I nderuar kryetar,

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **27 maj 2021**, pas shqyrtimit të propozimit të anëtares së kuvendit znj. Habibe Gërxhaliu lidhur me çështjen e sigurisë së qytetarëve në rrugën magjistrale gjegjësisht në ” Rr. “2 Maji”, pas debateve dhe analizës së hollësishme aprovon këtë:

REKOMANDIM

I Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i jepe mbështetje të plotë protestave dhe petitionit të qytetarëve që banojnë dhe gravitojnë përgjatë asaj rruge.

II Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon dhe kërkon nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të vendos sa më shpejt që të jetë e mundur semaforët në rrugën magjistrale N2 konkretisht në udhëkryq me Rrugën “2 Maji”, ashtu që të shmangen aksidentet me fatalitet siç edhe ka ndodhur më herët.

II Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon dhe kërkon nga kryetari i komunës që t'i parashtrij kërkesë komandantit të Stacionit Policorë në Vushtri, që të ketë vendosje të patrullimeve policore në rrugën magjistrale N2 që lidhë udhëkryqin me rrugën “2 Maji” konkretisht në vendkalim në rrugën magjistrale, ashtu që të kemi përkujdesje sidomos gjatë kalimit të fëmijëve (nxënësve).

12. Të ndryshme.

13. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, për mungesë e ujit të pjesshëm, ku të njëjti po kërkojnë që komuna të ndërmarr hapa konkret për futjen si projekt ndërtimin e stacionit të pompimit, pasi që pa një sistem të tillë nuk do të arrihet që uji të shkoj deri tek këto familje. Shqetësimi tjetër i këtyre banorëve është se në këtë fshatë ekziston një deponi inerte e mbeturinave ilegale e cila sidomos në këtë kohë të nxehtë po kundërmon tej mase dhe ekziston rrezik për shpërndaje të ndonjë epidemie, kjo deponi ndodhet mbi lagjen Kosumaj, Haxha dhe Hajra.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës, deri ku ka mbërri implementimi i Planit për Rimëkëmbje Ekonomike, çka po ndodhë me stacionin e autobusëve dhe me tregun e modelit Tirana?

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-në përgjigjen e tij ndaj anëtarit të kuvendit njoftoi se: për Planin për rimëkëmbje ekonomike, ka dërguar shkresat në Ministrinë e Financave për lejimin e zbritjes së tatimit për 20%, ka pasur takime me Departamentin e Ndihmës Shtetërore, ku kemi shpjeguar se ky plan nuk është një ndihmë direkte, por është një masë lehtësuese për qytetarët. Mandej ka kërkuar takim me Ministrin e Financave, që të mundësohet ridestinimi i buxhetit në muajin shtator, ashtu që të mundësohet që mjetet financiare të barten nga investimet kapitale, në subvencione në një masë të konsideruar, ashtu që të mundësohet punësimi i të rinjve, por në të njëjtën kohë i ka dërguar shkresë ministrisë, që çështja e ngrohtores së qytetit dhe parkingjet publike të futen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve sepse këto janë projektet që i japin kahe zhvillimit të Qytetit të Vushtrrisë për dhjetë vitet e ardhshme. Tutje për sa i përket çështjes së stacionit të autobusëve njoftoi se për dy vitet rresht të qeverisjes së tij ka ndarë nga 200,000.00 €, ndërsa që nga fillimi ka kërkuar nga ministria që të kthehet prona Komunës së Vushtrrisë. Në vitin e kaluar bashkë me nënkryetarin z.Muzaqi, kishin pasur takim me zëvendëskryeministrin dhe drejtorin e Burgjeve të Kosovës, ku ishin dakorduar, që komuna jonë të merr një pjesë të pronës të ish-motel vicianumit me qëllim të shfrytëzimit për stacion të autobusëve. Kontratën të cilën e ka lidhur Drejtorja e Burgjeve me operatorin ekonomik përmes ankandit publik, në një proces të

ligjshme ligjor, kur ky projekt është sjell në komunë Drejtoria e Urbanizimit i ka dhënë lejen ndërtimore, dhe ideja është që kur ky objekt pasi të përfundohet komuna ta merr me qira stacionin e autobusëve për shkak të leverdis ekonomike, sepse komuna do ti paguante 400,000.00 € qira për këtë objekt për 50 vitet e ardhshme, dhe kjo do ta ndihmonte komunën që mos të ketë barrë të rënd financiare. Por siç dihet publikisht Ministria e Drejtësisë e ka ndërprerë këtë kontratë, për çka komuna ka reaguar përmes shkresës zyrtare që komunës ti kthehet prona dhe përgjigja e tyre ka qenë se prona nuk mund ti kthehet komunës derisa të zgjidhet kontesti mes këtyre dy palëve. Ndërsa sa i përket tregut për prodhues vendor njoftoi se projekti është hartuar, studimi i fizibilitetit është kryer tërësisht, ndërsa komuna është duke pritur ndonjë donator që të kemi një bashkëfinancim për ndërtimin e këtij tregu. Lokacioni i paraparë është afër Interex, kemi një donator që ka shprehur interesim që të hynë në bashkëfinancim të këtij projekti, vlera e projektit është 550, 000.00 €, ndërsa donator ka premtuar se do ti ofroj rreth 300,000.00 €, ky projekt prite shumë shpejt të filloj dhe do të ketë një dinamik të zhvillimit si projekt prej 18 muajsh.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyeti se kush ka vendosur për lokacionin për ndërtimin e tregut për prodhuesit vendor.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se në kuadër të hartës zonale të Komunës së Vushtrrisë e cila është në procesin final të hartimit të saj, parashihet që në qyte të ndërtohen dy nënstacione të vogla, dhe objekti kryesor i stacionit të autobusëve, i cili do të jetë tek stacioni i trenit dhe kjo do të jetë pjesë e diskutimit të hartës zonale

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-pyeti se a do të ketë ujë të pijes për fshatin Smrekonicë, sepse uji atje nuk është duke shkuar, dhe në rastin konkret a do të përdoret ndonjë formë alternative e stacionit të pompimit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se në fshatin Smrekonicë, uji shkon pa pasur nevojë të vendoset stacioni i pompimit kjo ka dal në bazë të testimit. Por kemi një problem me ujësjellësin i cili duhet ta rritë shtypjen e ujit nga fabrika. Sa i përket tri lagjeve në fshatin Stanoc i Epërm, do të vendosen baster-pompat, këto do të testohen në fshatin Sfaracak dhe pastaj në secilin lagje ku do të ketë problem do të futen baster-pompat në gyp kryesor për ta rritë shtypjen e ujit për ato lagje. Pastaj njoftoi se në fshatin Druar, ka përfunduar procesi i ujësjellësit pas eliminimit të një problemi teknik, tani është lëshuar uji, dhe po ashtu njoftoi se ka filluar zhvillimi i projekti sa i përket ujësjellësit për fshatrat Stroc, Beçuk, dhe Bivolakë. Në Duminicë është duke përfunduar ky projekt dhe tani do të fillohet me Studimin e Epërme, Sllatinen dhe kështu do të kompletohet sistemi i ujësjellësit në tërë territorin e Komunës së Vushtrris, kjo provohet me faktin se deri me tani janë kyçur në rrjetin e ujësjellësit afër 7000 familje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-ngri çështjen e pllakave të thyera në sheshin e qytetit “Adem Jashari” ku kemi shumë shosh që janë dëmtuar dhe thyer e të cilat paraqesin rrezik të madh për qytetarët, për këtë pyeti sa ka projekt për rregullimin e tyre nga komuna. Çështja tjetër që ngrit është ajo se disa firma-kompani për grumbullimin e qumështit nuk po marrin qumështin nga fermerët tanë, pyeti drejtorin e drejtorisë, se a është informuar për këtë problematikë, sepse ka fermer që kanë deri në 25 krerë lopë dhe sot nuk ka ku e shet qumështin. Pastaj lidhur me shpërndarjen e shatë (7) rimorkiove për plehrat organike dhe të shatë këto rimorkio kanë ardhur me defekte dhe fermerët janë takuar me drejtorin, por akoma nuk kanë marr përgjigje, a ka ndonjë mundësi që ato rimorkio të rregullohen. Në fund pyeti se cili ka qenë çelësi i shpërndarjes së disa kompjuterëve për disa shkolla dhe a ka projekt që edhe shkollat tjera të pajisjen me kompjuter.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se në saj të një projekti të përbashkët me KEDS-in, kemi marr obligimin për rregullimin e pllakave të thyera në Sheshin “Adem Jashari”, ndërsa

KEDS-i ka për obligim largimin e kablllove, kurse komuna do bëjnë zëvendësimin e pllakave të thyera me kalldrëm por do të rregullohen edhe ujëmbledhësit.


Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-ngriti problemin e dëmtimit të kanalizimit në fshatin Studime e Poshtëm, nga kompania e që është duke bërë autostradën, kërkoj që të rregullohet kanalizimi. Po ashtu ceku dëmtimin e trotuarit nga rruga magjistrale në drejtim të fshatit Studime e Poshtme.

Kujtim Pllana, drejtor i DEBPZHR-së-tha se nuk kemi asnjë ankesë me shkrim nga ana e fermerëve, për mos marrjen e qumështit. Ndërsa lidhur, me defektet e rimorkiove, sqaroi se ky ka qenë një problem i trashëguar nga ish-drejtori, dhe pas konsultimeve me kontraktin ky problem është zgjidhur.

Afrim Haradinaj, nënkryetar i komunës-tha se kontrata për furnizim me pajisje kompjuterike për shkollat është një kontratë mjaft e gjerë, ku i përfshin jo vetëm shkollat dhe DKA-në por gjithë komunën. Dhe çelësi i shpërndarjes ka qenë shkollat që asnjë herë nuk janë pajisur me kompjuter.

Mbledhja përfundoi në ora 14:50.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

